

Gzim RUSHITI, MA¹

UDC: 342.517:343.292/.293(497.115)

**GJEOPOLITIKA DHE GJEOPOLITIKA E EVROPËS
JUGLINDORE (GADISHULLI BALLKANIK)**

**ГЕОПОЛИТИКА И ГЕОПОЛИТИКА НА ЈУГОИСТОЧНА
ЕВРОПА (БАЛКАНСКИ ПОЛУОСТОВ)**

**GEOPOLITICS AND GEOPOLITICS OF SOUTHEAST EUROPE
(BALKAN PENINSULA)**

Abstract

The history of geopolitical thought is very long and ideas with such a connotation are found from the period of antiquity. Although the origin of geopolitics is debatable, most opinions agree that it emerged in the late nineteenth and early twentieth centuries. The development of geopolitics according to historical periods is divided into three time periods. Geopolitics is inseparable from history. Geopolitics in a general sense is a discipline, which describes the connection between politics and territory, or more precisely space. The Balkan Peninsula is a geopolitical and cultural region of Southeast Europe. As a natural bridge connecting Europe with Asia, the Balkans are at the geopolitical and geostrategic heart of the region. The Balkans represent a diverse mosaic of historical, linguistic, religious, traditions, cultures, etc. Identities, which at certain moments have brought between the peoples and states of the Balkans and those who had political and strategic interests in the Balkans. The lack of peace and stability in the Balkans in the 1990s led to the involvement of many international organizations in the region, with a special emphasis on NATO and the EU for the restoration of

¹ Autori është student në studimet e Ciklit të tretë në Fakultetin Juridik në Manastir në Universitetin “Shën Klimenti i Ohrit”, drejtimi - E drejta ndërkombëtare dhe politika ndërkombëtare. Email: ge-zim1990@hotmail.com

peace and stability. Although the Balkans still face different challenges and threats, the future of the Balkans must be seen as a common challenge, challenge which is quite certain in the dual agenda of NATO and EU integration.

MENDIMI GJEOPOLITIK DHE ZHVILLIMI I GJEOPOLITIKËS SIPAS PERIUDHAVE KOHORE

Mendimi gjeopolitik ka një histori të gjatë dhe ide me një konotacion të tillë gjenden që nga periudha antike në veprat e Tukididit, Aristotelit dhe Herodotit, i cili në “Historinë” e tij thotë se “mënyra e jetesës së egjiptianëve, persëve, skithëve dhe grekëve, ishte në masë të madhe e ndikuar nga mjedisi fizik dhe gjeografik”.² Megjithëse origjina e gjeopolitikës është disi e diskutueshme, e vërteta është se shumica e mendimeve pajtohen se ajo u shfaq në fund të shekujve XIX ose në fillim të shekujve XX.³

Zhvillimi i gjeopolitikës sipas periudhave kohore:

- Era e parë gjeopolitike: Rivaliteti i fuqive imperialiste (1875-1945), ku theksohet se shfaqja e gjeopolitikës si një koncept dhe më pas si një praktikë ishte fillimisht brenda diskursit imperialist.

- Era e dytë gjeopolitike: Rendi botëror i Luftës së Ftohtë (1945-1990), ku diskursi gjeopolitik u zhvillua si në teori edhe në praktikë. Shpërthimi i Luftës së Ftohtë midis SHBA dhe BRSS siguroi një kontekst të ri për gjenerimin e fuqisë e dijes gjeopolitike në periudhën e pas luftës. Ndërsa gjeopolitika imperialiste e pjesës së hershme të shekullit të 20-të kishte tendencën të theksonte ndikimin kushtëzues dhe përcaktues të gjeografisë fizike mbi politikën e jashtme dhe strategjinë globale, gjeopolitika e Luftës së Ftohtë, që u prodhuan rreth antagonizmit SHBA-BRSS, e ndërthuri gjeografinë aq afër me ideologjinë sa që ishte e vështirë t’i ndaje nga njëra-tjetra.

- Gjeopolitika post-moderne: (1990 - ditët e sotme), na bind se gjeopolitika rinovohet dhe rispecifikohet si një qasje dhe praktikë pikërisht brenda diskursit mbi rendin e ri botëror.⁴

² Stevo Pendarovski, Siguria ndërkombëtare, Shkup, 2009, f. 136.

³ <https://sq.warbletoncouncil.org/geopolitica-4293#menu-2>

⁴ Mirela Metushaj, Pozicionimi gjeopolitik i Shqipërisë në periudhën postkomuniste pre dhe pas anëtarësimit në NATO (1992–2015), Punim Doktorature, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Tiranë, Mars, 2019, f. 30.

NOCIONI DHE KUPTIMI I GJEOPOLITIKËS

Gjeopolitika trajton çdo lloj rivaliteti në mes të pushteteve dhe të ndikimeve të tyre për territore, jo vetëm midis shteteve, por edhe në mes të pushteteve të të gjitha llojeve, veçanërisht të pushteteve të fshehta. Nga ana tjetër, vërejmë se gjeopolitika është e pandarë nga historia. Ajo na mëson të kuptojmë më mirë se si kemi arritur deri në ditët e sotme, në këtë apo në atë konflikt dhe në këtë apo në atë situatë gjeopolitike.⁵

Gjeopolitikë nënkupton drejtim doktrinar të gjeografisë politike sipas së cilës faktorët gjeografikë kanë rol të rëndësishëm në organizimin e politikës së jashtme dhe të brendshme të shtetit. Veçanërisht, rol të rëndësishëm luan madhësia e territorit, dalja në det dhe aftësia për t'u kontrolluar rrugët detare. Ky nocion mund të përdoret edhe për gjeografinë politike të kuptuar në strukturën e botës dhe shteteve si komponentë e saj, apo për t'i shënuar aspektet e politikës së jashtme të planifikuar, e cila duhet t'i merr parasysh faktorët e ndryshëm gjeografikë.⁶

Gjeopolitika në një kuptim të përgjithshëm është një disiplinë, e cila përkrahur lidhjen ndërmjet politikës dhe territorit, ose më saktë hapësirës. Kjo lidhje mund të jetë në nivel lokal ose në nivel ndërkombëtar. Rrathët që ajo përfshin brenda vetes, lëvizin që nga interpretimi i marrëdhënieve madhore, shtetërore dhe deri tek ato individuale të qytetarëve.

“Gjeopolitika” është një term modern dhe nuk ka më shumë se një shekull jetë. Ajo është një përgjigje e saktë për ndryshimet më të rëndësishme që kanë ndodhur në shekullin e shkuar dhe që po ndodhin edhe në shekullin aktual. Shpeshherë është konsideruar si të ishte një pseudo-shkencë, por në realitetin e fakteve ajo tenton thjesht shpjegimin e fenomeneve shoqërore të shtrira mbi hapësirën gjeografike.⁷

Termi “gjeopolitikë”, që në kohën e sotme ka një shumëllojshmëri përdorimesh, përdoret për të treguar gjithçka që ka lidhje me rivalitetet e pushteteve ose te ndikimeve mbi territore dhe popullsitë që jetojnë në to, rivalitete pak a shumë paqësore apo të dhunshme midis pushteteve politike të të gjitha llojeve dhe jo vetëm në mes shtetesh, por edhe në gjirin e pjesës më të madhe të tyre, në mes të lëvizjeve politike

⁵ Yves Lacoste, Gjeopolitika e Mesdheut, LIRA, Tiranë, 2011, f. 3.

⁶ Abdulla Azizi, Etem Aziri, Zemri Elezi, Fjalor - shumëdimensional i termave dhe shprehjeve administrative, politike, sociale dhe të diplomacisë, Shkup, 2009, f. 237.

⁷ Mirela Metushaj, Pozicionimi gjeopolitik i Shqipërisë në periudhën postkomuniste pre dhe pas anëtarësimit në NATO (1992–2015), Punim Doktorature, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Tiranë, Mars, 2018, f. 30.

apo të grupeve të armatosura pak a shumë të paligjshme, këto rivalitete ndodhin për të vendosur kontrollin apo sundimin mbi territore gjeografike të përmasave të mëdha apo të vogla.⁸

RËNDËSIA GJEOPOLITIKE E GADISHULLIT BALLKANIK E VENDIT KU PËRPLASEN GJEOGRAFIA DHE HISTORIA

Gadishulli Ballkanik është një rajon gjeopolitik dhe kulturor i Evropës Juglindore.⁹ Ballkani si një urë natyrore që bashkon Evropën me Azinë, ndodhet në “zembrën” gjeopolitike e gjeostrategjike të rajonit. E para është ishulli i Kretës që kontrollon të gjitha korridoret detare strategjike të Mesdheut Lindor dhe e dyta janë Serbia Jugore dhe Kosova, që konsiderohen si nyja tokësore më e rëndësishme pasi kontrollojnë të gjitha akset natyrore strategjike të rajonit.¹⁰

Për pjesën më të madhe të së kaluarës evropiane, Ballkani nuk ishte një rajon koherent, përkundrazi, ai edhe vetë ishte i ndarë në shumë nga ndarjet më të rëndësishme në historinë e kontinentit, disa prej të cilave edhe sot ndikojnë në politikën e rajonit. Këtu kalonte kufiri midis Perandorisë Romake Lindore dhe Perëndimore, kufiri i depërimit të fiseve sllave, kufiri midis kishës katolike dhe asaj ortodokse dhe kufiri midis Perandorisë Osmane dhe Perandorisë Habsburge.

Ballkani modern u formua me shpërbërjen e dy perandorive të fundit dhe mund të thuhet se shumë nga dallimet midis vendeve pasardhëse burojnë nga dallimet që ekzistonin midis këtyre dy perandorive. Në këtë kontekst, trashëgimia osmane është veçanërisht komplekse.¹¹

Ballkani përfaqëson një mozaik të larmishëm identitetesh historike, gjuhësore, fetare, traditash, kulturash, zakonesh, politike, shtetërore, etj., të cilat në momente të caktuara kanë sjellë përplasje të dhunshme jo vetëm ndërmjet shteteve dhe popujve që kanë banuar në këtë rajon, por edhe atyre që kanë pasur interesa politike, strategjike, ekonomike në Ballkan. Kjo ka qenë dhe një nga faktorët kryesorë që Ballkani gjatë shekujve të XIX-XX ka regjistruar një mori konfliktesh të

⁸ Yves Lacoste, Gjeopolitika e Mesdheut, LIRA, Tiranë, 2011, f, 5

⁹ https://sq.wikipedia.org/wiki/Gadishulli_Ballkanik#Histori_dhe_r%C3%ABnd%C3%ABsin%C3%AB_gjeopolitike

¹⁰ Pajtim Ribaj, Shpëtim Cami, Lufta, Paqja, Siguria – Realitete Ballkanike, Tiranë, 2015, f, 194.

¹¹ Stevo Pendarovski, Siguria ndërkombëtare, Shkup, 2009, f, 72.

pakrahasueshëm për nga hapësira gjeografike dhe popullsia që përfaqëson.¹² Konfigurimi i Ballkanit nuk është produkt vetëm i dorës së shteteve dhe popujve që jetojnë në këtë rajon, por edhe i fuqive të mëdha që në momente të caktuar kanë përkrahur dhe mbrojtur interesat e tyre gjeopolitike, gjeostrategjike dhe gjeoekonomike. Ndikimi i tyre është shfaqur që në shekullin XIX dhe vazhdon edhe sot.¹³

Historia ishte dhe mbeti një, pa marrë parasysh rishikimin e saj politik. Gjeografia ndryshon në Ballkanin e trazuar, por historia nuk mund të ndryshohet nga regjimet politike, sado që kjo qe provuar jo një herë. Gjeografia, përkohësisht edhe mund të ndryshohet, por jo edhe historia. Kufijtë mund të ndërrojnë, por ata nuk janë të përhershëm, sikur edhe asgjë në këtë botë. Historia, së paku i afrohet kësaj përhershmërie me dëshmitë për një të kaluar të arkivuar. Populli që ka jetuar bashkë me shekuj, ndodhë që përkohësisht edhe të ndahet, së paku politikisht, por jo edhe historikisht. Ata që kanë jetuar së bashku me shekuj, nuk mund t'i ndaj një tërheqje e kufirit, aq më pak t'i zhbëjë, apo t'i zhdukë një gjeografi e re. Ata nuk fshihen aq lehtë nga historia, nëse përkohësisht janë fshirë nga gjeografia. Me ndryshimin e kufijve, kombet virtualisht edhe mund të zhvendosen në gjeografi të reja, por ata nuk mund të zhvendosen nga historia.

Ata mbeten aty, realisht në ato territore, që përkohësisht mund të riemërohen politikisht në shtete tjera, apo të reja, por ato nuk zhduken nga historia. Jurisdikcionet e reja shtetërore, që vijnë e shkojnë në histori, nuk mund t'i shpallin këta popuj, si diçka e re, e shpikur që është krijuar krahas krijimit të gjeografisë së re. Substanca kombëtare është aty, ajo nuk mund të zhduket edhe pas rishikimit të hartave të reja gjeografike. Kjo substancë kombëtare edhe në gjeografinë e re mbijeton, është e qëndrueshme dhe i përballon sfidave të kufijve të rinj. Ajo mbetet në historinë e vjetër, edhe nëse mohohet në gjeografinë e re, sepse historia është më e qëndrueshme se gjeografia. Fundja, e para na tregon për të dytën.¹⁴ Me fjalë të tjera, vendet ballkanike paraqesin arterien kryesore për shumë vende botërore në shkëmbimin tregtar dhe të energjisë, veçanërisht në këtë fillim të shekullit XXI.¹⁵

¹² Gëzim Mustafaj, *The Heritage*, Revistë Periodike, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Nr. 6, 2011, f. 45.

¹³ Gëzim Mustafaj, *The Heritage*, Revistë Periodike, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Nr. 6, 2011 f. 51.

¹⁴ Blerim Reka, *Gjeopolitika dhe teknika e zgjerimit të UE-së*, ASPECT, Bruksel, 2010, f. 320.

¹⁵ Phd.Cand. Fidan Mustafa, *ALBANIAN GEOPOLITICAL UNCERTAINTIES IN BALKAN*, *The Heritage*, Reviste Periodike, Nr. 20, 2018, f. 53.

KUPTIMI I TERMIT BALLKAN NË SKENËN GJEOPOLITIKE DHE BALLKANI PERËNDIMOR SI KONFIGURIM GJEOPOLITIK

Nga një vështrim i termit Ballkan si dhe gjithë historisë së tij shekullore, mund të themi se, përgjithësisht, ky term tregon një lidhje me dhunën, konflikte fetare, përplasje etnike, si dhe kuptimin e një zone të thellë. Po kështu, edhe kalimi nga termi Gadishulli Ballkanik në fjalën ballkanas, si dhe deri tek derivati i saj “ballkanizim”, ishte si rezultat i fillimit të rënies së Perandorisë Osmane, i luftërave në rajon dhe i Luftës së Parë Botërore.¹⁶ Gjatë shekullit të XX në Ballkan është zhvilluar një total prej 7 luftërash, të cilat kanë bërë që territoret e tij të ndryshohen e zvogëlohen vazhdimisht, duke ndryshuar njëkohësisht edhe identitetin e rajonit. Në kohën e Perandorisë Osmane ky rajon është njohur me emrin Rumeli ose osmanët evropianë. Shumica e autorëve të shekullit të XIX e quanin Turqia Evropiane, Lindja e Afërt, Levanti Evropian, etj.¹⁷

Nuk ka një cak kohor që të mund të referohet si pikënisje për termin Ballkan Perëndimor, por më së shumti ky koncept u bë një zonë reference kryesisht pas vitit 1990.¹⁸ Është e natyrshme që një rajon si Ballkani, ashtu si çdo rajon, zonë apo vend tjetër ka referencat e tij të orientimit apo të ndarjes gjeografike. Rajonet, zonat apo vendet dallohen gjithashtu edhe për nga shkalla e zhvillimit, e veçorive kulturore apo religjionit. Edhe vendet që shtrihen në Ballkanin Perëndimor kanë një pasuri të pafund vlerash të tilla, madje unike për Evropën e më gjerë. Gjithsesi identifikimi i këtij rajoni me këtë emër duket se nuk ka ardhur aq shumë si nevojë për të identifikuar veçoritë apo pasuritë e vlerave të tilla. Më së shumti kërkesa për ta “kornizuar” këtë rajon ka lindur si nevojë për ta menaxhuar këtë rajon relativisht të prapambetur, për ta sjellë në përshtatje me rrjedhat dhe nivelet evropiane të zhvillimit. Prandaj edhe termi “Ballkan Perëndimor” shpreh më shumë lindjen dhe evoluimin e një koncepti politik, sesa të një koncepti gjeografik.¹⁹

¹⁶ Pajtim Ribaj, Shpëtim Cami, Lufta, Paqja, Siguria – Realitete Ballkanike, Tiranë, 2015, f. 192

¹⁷ Pajtim Ribaj, Shpëtim Cami, Lufta, Paqja, Siguria – Realitete Ballkanike, Tiranë, 2015, 193

¹⁸ Ilirjan Çukaj, Dinamikat gjeopolitike të Ballkanit Perëndimor dhe rrjedhat shqiptare, Punim Doktorature, Universiteti i Tiranës, Instituti i Studimeve Evropiane, Programi i doktoraturës në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, Tiranë, 2016, f. 66.

¹⁹ Mirela Metushaj, Pozicionimi gjeopolitik i Shqipërisë në periudhën post – komuniste pre dhe pas anëtarësimit në NATO (1992–2015), Punim Doktorature, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Tiranë, Mars, 2019, f. 35.

KONTRIBUTI I NATO-s DHE I BE-së PËR RUAJTJEN E PAQES DHE SIGURISË NË EVROPËN JUGLINDORE

Konflikti dhe mungesa e stabilitetit në Ballkan në vitet 1990, mbartte në vetvete sfida të drejtpërdrejta ndaj interesave të sigurisë së vendeve anëtarë të NATO-s dhe më gjerë. Këto sfida dobësonin paqen dhe stabilitetin në Evropë. Diçka e tillë e çoi Aleancën në ndërmarrjen e operacioneve të mbështetjes së paqes dhe të administrimit të krizave, fillimisht në Bosnjë dhe Hercegovinë, më pas në Kosovë dhe më vonë në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Më 1999, kriza e Kosovës ishte shtysa që bashkësia ndërkombëtare të rivlerësonte zotimin e saj në rajon dhe të përshtaste një qëndrim më gjithë përmbledhës në mbështetje të sigurisë e të stabilitetit.

Kjo u shfaq në Nismën e Evropës Juglindore të NATO-s, si dhe në Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore. Që prej asaj kohe, përfshirja e NATO-s në forcimin e sigurisë dhe të stabilitetit në Evropën Juglindore është zgjeruar mbi caqet e paqeruajtjes, nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit për çështjet e sigurisë në rajon.²⁰

Për Bashkimin Evropian interes dhe përkushtim prioritar ka qenë dhe do të mbetet Ballkani Perëndimor. Duke analizuar situatën aktuale që mbretëron në Ballkanin Perëndimor ose thënë më mirë brenda vendeve të këtij rajoni mund të konstatojmë se pas gjithë këtyre përpjekjeve dhe angazhimeve në terren natyrisht që ka ende probleme dhe sfida që duhet këto shtete t'i tejkalojnë dhe së bashku me një bashkëpunim të mirëfilltë me komunitetin ndërkombëtar që të bëhen pjesë e saj. Që nga Samiti i Selanikut, pasi që institucionet evropiane deklaruan se “e ardhmja e Ballkanit është në Bashkimin Evropian”, është kuptuar qartë ndikimi pozitiv në forcimin e marrëdhënieve me BE-në në realizimin socio-ekonomik të vendeve të rajonit.²¹

Zhvillimi i bashkëpunimit rajonal është në dobi të interesave të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor: ai është një faktor për stabilitet politik, siguri dhe prosperitet ekonomik.²² Perspektiva e afrimit të

²⁰ MANUAL I NATO-S, Public Diplomacy Division NATO, 1110 Brussels, Belgium, 2006, f. 253.

²¹ Blerim Reka, Otmar Holl, Ylber Sela, Institucionet dhe politikat e Unionit Evropian, Forumi për Shoqëri, Shkencë dhe Kulturë “UNIVERSITAS”, Tetovë, 2010, f. 180.

²² Najada Kilic, Bashkëpunimi rajonal në frymën e dialogut dhe mirëkuptimit, faktor bazë për zhvillimin dhe integrimin e Ballkanit Perëndimor, The Heritage, Revistë Periodike. Nr. 2, 2010, f. 66.

shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe integrimi i plotë i tyre në BE kanë luajtur rol të rëndësishëm në stabilizimin politik, ekonomik dhe social, duke zbutur efektet e konflikteve të brendshme dhe transformimeve sistematike në vendet e rajonit. Edhe nëse përparimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor vazhdon me shpejtësi të ndryshme, për të gjithë ato, shpresa e anëtarësimit eventual është një faktor dhe katalizator i rëndësishëm mobilizues në mbajtjen e reformave.²³

SFIDAT GJEOPOLITIKE TË SË ARDHMES TË GADISHULLIT BALLKANIK DHE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Ballkani Perëndimor, për kujtesë të auditorit, përbëhet nga shtatë shtete si: Kroacia, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi, Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Serbia. Ky lloj rajonizimi gjeografik, përfshin shtete me fuqi, strategji dhe histori të ndryshme, pjesë e luftërave ballkanike dhe atyre botërore, vatra të nxehta konflikti dhe problemesh të pazgjidhura edhe sot e kësaj dite. Në këtë lloj gjendje gjeopolitike, leadershipet ndodhen para sfidave të mëdha historike.²⁴

Në Ballkan, edhe më tutje historia dhe ambiciet për shtete të mëdha e problematizojnë ardhmërinë e qetë dhe nuk lejojnë shfrytëzimin maksimal të potencialit për bashkëpunimin rajonal. Njëkohësisht, në garën për përfitimin e interesave të aktorëve të rëndësishëm strategjikë, në kuadër të sigurisë ndërkombëtare (BE, NATO, vendet të cilat janë pjesë të Këshillit të Sigurisë të OKB-së dhe vendet-lider në kuadër të BE dhe të NATO-s), secili nga vendet ballkanike dëshiron të paraqitet si më i rëndësishëm në aspekt gjeostrategjik, me këtë rast, pa i perceptuar realisht mundësitë dhe kapacitetet kombëtare. Me rivalitetin historik ndërkombëtar dhe me mbështetjen ndërkombëtare, të cilën e kanë/e kanë pasur ndër vite shtete të caktuara ballkanike, të mbështetura me ambicie politike të liderëve politikë, shpjegohen shkaqet dominuese për nxitjen e konflikteve ndërshtetërore dhe të brendshme në hapësirat e Ballkanit, ndërkaq konfliktet ndërshtetërore shpeshherë ndërlidhen me shkaktimin e konflikteve të brendshme - si reagim i realizimit të interesave të ndryshme të grupeve të caktuara etnike dhe për shkak të

²³ Blerim Reka, Otmar Holl, Ylber Sela, Institucionet dhe politikat e Unionit Evropian, Forumi për Shoqëri, Shkencë dhe Kulturë "UNIVERSITAS", Tetovë, 2010, f. 182.

²⁴ Shpëtim Cami, Siguria energjetike dhe sfidat e leadershipit rast studimi: Ballkani Perëndimor, The Heritage, Revistë Periodike, Nr. 7. 2011, f. 153

urrejtjes midis grupeve të ndryshme etnike, të cilat jetojnë në kuadër të një tërësie të njëjtë territoriale. Megjithatë, mund të thuhet se rajoni, pas një sërë të ngjarjeve “fatkeqe”, shënon progres në menaxhimin me sfidat rajonale të sigurisë.²⁵

Pas më shumë se dy dekada të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, shtetet e shpallura të Ballkanit Perëndimor, janë duke u përballur me dilemat e konfliktit etnik, stabilizimit të brendshëm, integritit në strukturat ushtarake-ekonomike të Perëndimit dhe kërkimit të aleancave të reja rajonale-globale. Ky trend i ri që është i pranishëm nëpër disa shtete të Ballkanit Perëndimor, rrjedh nga fakti se për disa shekuj, kjo hapësirë gjeografike, është bazuar në sisteme të ndryshme të organizimit të shtetit. Kështu, që nga koha e sundimit Romak, Bizantin, Osman, dhe së fundi dominimit Habsburg dhe komunist, rajoni është ballafaquar me dilemën e sigurisë - aleancave, dhe siç duket së fundi, ky sindrom, tani është duke u bërë pjesë e politikës së jashtme së shteteve të brishta.²⁶

Si duket, objektivi kryesor i Perëndimit në Ballkan është stabilizimi i rajonit në një mënyrë të tillë që të mos kërkojë ndërhyrjen të drejtpërdrejtë të forcave të drejtuara nga NATO apo prani civile ndërkombëtare dhe kanalizimin e saj drejt integritit në institucionet euro-atlantike.²⁷

OKB-ja vazhdimisht ka theksuar nevojën e pajtimit ndërkombëtar dhe rajonal në Ballkanin Perëndimor.²⁸ Është e padiskutueshme që kjo e ardhme është evropiane. Është shumë e rëndësishme që krahas interesave kombëtare vendet e Ballkanit të marrin në konsideratë dhe interesat rajonale. Një nga prioritetet më të rëndësishme duhet të jetë forcimi i dimensionit të stabilitetit, demokratizimit të shoqërisë, luftës së përbashkët ndaj krimit të organizuar dhe trafikeve, kontrollit të qarkullimit dhe konfiskimit të parave që disponojnë këto organizata, forcimit dhe përmbushjen e standardeve më të larta të sigurisë dhe menaxhimit të integruar të kufijve.²⁹

²⁵ Rade Rajkovçevski, Ndërtimi i politikës së sigurisë: rasti i Republikës së Maqedonisë, Shkup, f. 49.

²⁶ Selim Ibraimi, Paqja e Ftohtë - Dhjetëvjeçari i rikonfigurimeve gjeopolitike në Ballkan, Qendra për Studime të Sigurisë dhe Zhvillim, Tetovë, 2016, f. 79.

²⁷ Pajtim Ribaj, Shpëtim Cami, Lufta, Paqja, Siguria - Realitete Ballkanike, Tiranë, 2015, f. 196.

²⁸ Phd. Candidate, Albert Hitoaliaj, Kanali Danub-Egje dhe loja e madhe gjeopolitike, The Heritage, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Nr. 10, 2013, f. 147.

²⁹ Gëzim Mustafaj, The Heritage, Revistë Periodike, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, NR. 6, 2011, f. 52.

PERSPEKTIVAT DHE ORIENTIMI GJEOPOLITIK I EVROPËS JUGLINDORE NË TË ARDHMEN

Evropa nuk ka qenë kurrë më e lirë dhe më e sigurt se sa që është tani. Luftërat dhe dhuna e shkaktuar në shekullin e XX, Evropës i ka hapur një rrugë drejt paqes, stabilitetit dhe prosperitetit të gjithmbarshëm. Krijimi i Bashkimit Evropian ka qenë themelor në këtë zhvillim, ai i ka transformuar marrëdhëniet ndërmjet shteteve dhe jetën e qytetarëve evropianë. Vendet evropiane kanë premtuar të përballen paqësisht me vështirësitë dhe të bashkëveprojnë nëpërmjet institucioneve të caktuara. Zgjerimi i suksesshëm i BE-së do ishte një vizion që kontinenti i Evropës të jetë i bashkuar, paqësor dhe me një zhvillim ma të mire ekonomik. Para një viti e gjysmë, veçanërisht pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Prespës, takimet e Samitit Evropian në vendin tonë perceptohen si një ngjarje që do të përcaktojë nëse do të jemi apo jo pjesë e BE-së. Samiti i fundit në mes të tetorit 2019 nuk bën përjashtim nga ky rregull. Në ditët e ardhshme, vendet anëtare të BE-së do të ulen përsëri në tryezë për të provuar të arrijnë një konsensus nëse do të mbështesin rekomandimin e Komisionit Evropian që vendi ynë të fillojë negociatat e pranimit.³⁰

Sot, kur po krijohet një rend i ri botëror, kur ky rend i ri botëror nuk po krijohet me luftë, si rendet e përparme botërore, por me mjete demokratike dhe në mënyra paqësore, thuhet se u ka kaluar koha rreshtimeve të reja gjeopolitike. Po, rreshtime gjeopolitike, megjithatë, mund të vërehen në Ballkan. Dhe, kjo është plotësisht e kuptueshme: çështjet ballkanike kurrë nuk janë ngatërruar dhe kurrë nuk janë zgjidhur pa ndihmën e fuqive jashtë Ballkanit. Popujt e vegjël në Ballkan dhe kudo në botë janë të vetëdijshëm se interesat e tyre kurrë nuk kanë mund dhe nuk do të mund t'i sendërtojnë as tani e tutje pa gëzuar ndihmën e ndonjë aleance a ndonjë fuqie evropiane a botërore.³¹

Me përfundimin e periudhës së Luftës së Ftohtë, rënies së Murit të Berlinit dhe shpërbërjes së Jugosllavisë, strategjitë e reja me impakt Ballkanin, kanë marrë trajtën e implementimit gjeostrategjik të intereseve transkontinentale. Rajoni i Ballkanit, aktualisht mbetet baza më e fuqishme ushtarake e NATO-s në Evropë, me një prezencë ushtarake të shpërndarë në gjitha vendet e rajonit, ndërsa në anën tjetër vendet

³⁰ Senada Laçka, Shemsije Demiri, Guximtar Rushani, The Heritage, Revisë Periodike, Nr. 22. 2019, f. 71.

³¹ Rexhep Qosja, Çështja Shqiptare – Historia dhe Politika, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1994, f. 299.

ballkanike tashmë kanë përcaktuar rrugën integruese drejt anëtarësimit në NATO dhe Bashkimin Evropian.³²

Në diplomacinë evropiane të periudhës së post-komunizmit ndeshen dy shkolla mendimi lidhur me orientimin gjeostrategjik, që i duhet dhënë Gadishullit Ballkanik. Njëra shkollë mendimi i përmbahet pikëpamjes së Ballkanit i duhet një shtet, që të ketë statusin e udhëheqësit në rajon, që duhet të drejtojë dhe të disiplinojë rajonin klasik të trazirave dhe të kryeneçësive, shkolla tjetër e mendimit i përmbahet mendimit se në kohën e zhvillimeve demokratike dhe të politikave të të gjitha shteteve ballkanike për integrim euro-atlantik është më e drejtë që Ballkani të jetë shumëpolar, pra që shtetet e rajonit të kenë status të barabartë në raport me njëri-tjetrin dhe në raport me faktorin ndërkombëtar.³³

Çështja themelore e përplasjes së koncepteve dhe e politikave mes dy shkollave të mendimit dhe grupeve të shteteve evropiane është se, cili shtet duhet të ngarkohet me këtë detyrë gjeostrategjike për të marrë rolin e liderit të rajonit. Elementet për t'i dhënë një shteti statusin ose rolin udhëheqës në rajon janë të shumta dhe ato nisin me fuqinë ekonomike, ushtarake, të burimeve energjetike dhe lëndëve të para energjetike, të kryqëzimit të rrugëve të rëndësishme të transportit ndërkombëtar, e deri tek lidhjet e veçanta që shteti i zgjedhur mund të ketë me një fuqi ose me një superfuqi.³⁴

Sot vendet e Ballkanit ndodhen në një mjedis të ri rajonal dhe global të sigurisë dhe stabilitetit. Koha e stuhive dhe përplasjeve të mëdha duhet të konsiderohet e mbyllur dhe e ardhmja e rajonit duhet të shikohet si një sfidë e përbashkët.³⁵ E ardhmja gjeopolitike e Ballkanit është mjaft e sigurt në agjendën e dyfishtë të integritit të NATO-s dhe BE-së, megjithatë, sfidat e ardhshme me të cilat do të përballemi do të jenë me karakter funksional dhe përmbajtjen e tyre ndërrajonale (demokratizimi, zhvillimi ekonomik, ekstremizmi fetar, terrorizmi). Megjithëse potenciali për luftë ndërshtetërore ose përhapje të organizuar të dhunës politike përtej kufijve është reduktuar ndjeshëm, Evropa Juglindore do të vazhdojë të jetë burim i sfidave të sigurisë të një profili

³² Fidan Mustafa, ALBANIAN GEOPOLITICAL UNCERTAINTIES IN BALKAN, The Heritage, Revistë Periodike, Universiteti Ndërkombëtarë i Strugës, Nr. 20, 2018, f. 54

³³ Pajtim Ribaj, Shpëtim Cami, Lufta, Paqja, Siguria - Realitete Ballkanike, Tiranë, 2015, f. 198.

³⁴ Pajtim Ribaj, Shpëtim Cami, Lufta, Paqja, Siguria - Realitete Ballkanike, Tiranë, 2015, f. 199.

³⁵ Gëzim Mustafaj, The Heritage, Revistë Periodike, Universiteti Ndërkombëtarë i Strugës, Nr. 6, 2011, f. 52

tjetër, përkatësisht hyrja në lojë e të ashtuquajturës aktorët joshtetërorë - krimi i organizuar dhe rrjetet terroriste.³⁶

Ballkani tani është plotësisht i orientuar drejt BE-së, drejt kësaj organizate ku ato shihnin perspektivën e tyre ekonomike. Edhe BE-ja është zotuar për zgjerimin e saj në drejtim të Ballkanit Perëndimor, pra të përfshirjes në gjirin e saj edhe të atyre shteteve që ende nuk janë të anëtarësuara. Gjithashtu, ajo që është pozitive në një analizë të sigurisë në Ballkan, është fakti se të gjitha shtetet, pa përjashtim, kanë shprehur interesimin e tyre për anëtarësimin në paktin NATO. Klima e volitshme ekzistuese e sigurisë e krijuar në këtë rajon është edhe meritë e shtrirjes së Aleancës Veri-Atlantike si dhe anëtarësimit në të, i një numrit sa më të madh të shteteve të Ballkanit. Gjeopolitika e vendeve të rajonit, nuk ndikohet vetëm nga zhvillimet ndërshtetërore të vendeve të saj, por edhe nga ndikimi në mënyrë të drejtpërdrejtë i Fuqive të Mëdha nëpërmjet institucioneve ndërkombëtare politike, ekonomike dhe ushtarake. Ky problem përcillet nga historia dhe ende vijon të jetë i pranishëm.³⁷ Prandaj lirisht mund të thuhet se roli dhe ndikimi i Fuqive të Mëdha në Ballkan ka qenë dhe do të mbetet vendimtar, e kjo pikësëpari, për shkak të pozitës gjeostrategjike të këtij rajoni.³⁸

CONCLUSION

Although geopolitical thought has a very long history, most geopolitical scholars agree on the view that geopolitics emerged in the late nineteenth or early twentieth century. In the literature on geopolitics can be found numerous definitions of what geopolitics really is, but from all the definitions of geopolitics that exist if we analyze them we can conclude that geopolitics is inseparable from history and that geographical factors play a crucial role in organizing the foreign and domestic policy of a state in terms of geopolitics. Serving as a natural bridge who connecting Europe with Asia, the Balkan Peninsula represents a very important geopolitical region. Because many different cultures, identities, religions and nations live together in the Balkan Peninsula, this at certain moments throughout history has led to clashes and

³⁶ Stevo Pendarovski, Siguria ndërkombëtare, Shkup, 2009, f, 147.

³⁷ Pajtim Ribaj, Shpëtim Cami, Lufta, Paqja, Siguria - Realitete Ballkanike, Tiranë, 2015, f. 207.

³⁸ Pajtim Ribaj, Shpëtim Cami, Lufta, Paqja, Siguria - Realitete Ballkanike, Tiranë, 2015, f. 203

various wars and conflicts, the resolution of which in certain cases has been needed for the intervention of the international factor, as was the case with the conflicts that took place in the Balkan Peninsula in the 1990s. Today, the Balkan Peninsula, although facing various challenges, its future is secure, and we can competently conclude that the future of this region today is more secure than ever during its history in the context of Euro-Atlantic integration. Today, in the 21st century, the Balkan Peninsula, although it is facing many challenges, by thoroughly analyzing this region or the policy of the constituent states of Southeast Europe separately and competently we can conclude that this region has a secure future within the Euro-Atlantic integration into NATO and the European Union.

LITERATURA

1. Abdulla Azizi, Etem Aziri, Zemri Elezi, Fjalor shumëdimensional i termave dhe shprehjeve administrative, politike, sociale dhe të diplomacisë, Shkup, 2009
2. Blerim Reka, Gjeopolitika dhe teknika e zgjerimit të UE –së, ASPECT, Bruksel, 2010
3. Blerim Reka, Otmar Holl, Ylber Sela, Institucionet dhe politikat e Unionit Evropian, Forumi për Shoqëri, Shkencë dhe Kulturë “UNIVERSITAS”, Tetovë , 2010
4. MANUAL I NATO-S, Public Diplomacy Division NATO, 1110 Brussels, Belgium, 2006
5. Stevo Pendarovski, Siguria ndërkombëtare, Shkup, 2009
6. Rade Rajkovçevski, Ndërtimi i politikës së sigurisë: rasti i Republikës së Maqedonisë, Shkup
7. Selim Ibraimi, Paqja e Ftohtë - Dhjetëvjeçari i rikonfigurimeve gjeopolitike në Ballkan, Qendra për Studime të Sigurisë dhe Zhvillim, Tetovë
8. Pajtim Ribaj, Shpëtim Cami, Lufta, Paqja, Siguria - Realitete Ballkanike, Tiranë, 2015
9. Rexhep Qosja, Çështja Shqiptare - Historia dhe Politika, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1994
10. Yves Lacoste, Gjeopolitika e Mesdheut, LIRA, Tiranë, 2011
11. Ilirjan Çukaj, Dinamikat gjeopolitike të Ballkanit Perëndimor dhe rrjedhat shqiptare, Punim Doktorature, Universiteti i Tiranës,

Instituti i Studimeve Evropiane, Programi i doktoraturës në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, Tiranë , 2016

12. Mirela Metushaj, Pozicionimi gjeopolitik i Shqipërisë në periudhën post - komuniste pre dhe pas anëtarësimit në NATO (1992–2015), Punim Doktorature, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Tiranë, Mars, 2009

13. Phd. Candidate, Albert Hitoaliaj, Kanali Danub-Egje dhe loja e madhe gjeopolitike, The Heritage, Universiteti Ndërkombëtarë i Strugës, Nr. 10, 2013

14. Phd.Cand. Fidan Mustafa, ALBANIAN GEOPOLITICAL UNCERTAINTIES IN BALKAN, The Heritage, Reviste Periodike, Nr. 20, 2018

15. Gëzim Mustafaj, The Heritage, Revistë Periodike, Universiteti Ndërkombëtarë i Strugës, Nr. 6, 2011

16. Najada Kilic, Bashkë punimi rajonal në frymë n e dialogut dhe mirë kuptimit, faktorë bazë për zhvillimin dhe integrimin e Ballkanit Perëndimor, The Heritage, Revistë Periodike, Universiteti Ndërkombëtarë i Strugës, Nr. 2, 2010

17. Shpëtim Cami, Siguria eneregjetike dhe sfidat e lidershipit rast studimi : Ballkani Perëndimor, The Heritage, Revistë Periodike, Nr. 7. 2011

18. Senada Laçka, Shemsije Demiri , Guximtar Rushani, The Heritage, Revisë Periodike, Universiteti Ndërkombëtarë i Strugës, Nr. 22. 2019

BURIME NGA INTERNETI

1. <https://sq.warbletoncouncil.org/geopolitica-4293#menu-2>
2. https://sq.wikipedia.org/wiki/Gadishulli_Ballkanik#Histori_dhe_r%C3%ABnd%C3%ABsin%C3%AB_gjeopolitike